



Pavijoni Shqiptar
Bienalja e 59-të e Venecias
Arsenale
23 Prill - 27 Nëntor 2022
Lumturi Blloshmi
“Nga e para”
Kuruar nga Adela Demetja

Lumturi Blloshmi (1944–2020), do të jetë artistja e parë femër që përfaqëson Shqipërinë me një prezantim personal në Venecia dhe Adela Demetja do të jetë e para kuratore shqiptare femër e Pavijonit Shqiptar. Demetja u miqësua me Blloshmin në vitin 2016 dhe ka qënë një nga bashkëpunëtorët e saj më të ngushta deri në fundin e jetës së artistes.

Biografia e jashtëzakonshme e Lumturi Blloshmit, personaliteti i saj i fuqishëm dhe mbi të gjitha vepra artistike cilësore, e bëjnë atë vlerë unike dhe domethënëse për artin bashkëkohor kombëtar dhe ndërkombëtar. Puna e Lumturi Blloshmit përshtatet gjithashtu më së miri me temën e këtij viti të Bienales së Artit të Venecias titulluar “Qumështi i ëndrrave”. Ky titull është huazuar nga një libër i artistes Leonora Carrington, në të cilin, siç thotë kuratorja e Bienales Cecilia Alemani, “artisti surrealist përshkruan një botë magjike ku jeta rishihet vazhdimisht përmes prizmit të imagjinatës dhe ku çdokush mund të ndryshojë, transformohet, të bëhet diçka dhe dikush tjetër. Ekspozita na fton në një udhëtim imagjinar përmes metamorfozave të trupit dhe përkufizimeve të njerëzimit.”

Si pothuajse të gjithë artistët e brezit të saj, Lumturi Blloshmi pikturoi deri në fund të viteve '80 në stilin e realizmit socialist. Megjithatë, pas viteve '90 ajo ishte një nga të paktët artistë të brezit të saj që arriti të ripozicionojë dhe transformojë vazhdimisht e po ashtu sukseshëm veten dhe punën e saj deri në fund të jetës. Veprat e Lumturi Blloshmit në pikturë, fotografi, instalacion dhe performancë karakterizohen nga një ironi e caktuar dhe mënyra e dallueshme e reflektimit dhe tejkalimit të realitetit në të cilin ajo

jetoi. Personaliteti i saj dinamik dhe vetëdija, e ushqyer nga filozofia, poezia, sensualiteti dhe spiritualiteti, i kanë dhënë formë një veprë të veçantë që dëshmon rrugëtimin e jashtëzakonshëm të një shpirti krijues që duroi dhe krijoi pavarësisht kufizimeve politike, fizike dhe ideologjike të imponuara nga jeta dhe nga konteksti i veçantë i Shqipërisë komuniste pas Luftës së Dytë Botërore.

Blloshmi qëndronte në mes të kozmosit të saj, jo si një vëzhguese pasive, por si një pjesëmarrëse aktive. Kjo e lejoi atë të shprehte hapur pikëpamjet e saj për botën e artit dhe mekanizmat e saj e gjithashtu për shoqërinë e së cilës ishte pjesë. Këndvështrimi i saj ishte ai i një gruaje të fortë që kritikonte dhe provokonte me humor pushtetin e dominuar nga burrat. Ajo që e bën të veçantë veprën e saj është thjeshtësia simbolike dhe optimizmi i përdorur në trajtimin e realitetit të ashpër. Shpesh, Blloshmi e ka paraqitur veten në pikturat, performancat dhe fotografitë e saj. Nëpërmjet subjektivitetit, ajo krijoi qartë një marrëdhënie mes vetes dhe kontekstit social-politik, e cila e lejoi atë dhe ne gjithashtu të perceptojmë historinë dhe realitetin nga një këndvështrim i vetëpërcaktuar dhe personal.

Duke kultivuar dhe ripërshtatur një qasje që shkon përtej feminizmit, kombësisë dhe stileve specifike të artit, Blloshmi u rezistoi pa u lodhur regjimeve dhe zhvillimeve të ndryshme duke ndërtuar një praktikë të bazuar në përvojën e saj personale, duke kaluar nga tipi (shqiptare, femër, e përndjekur politikisht, e paaftë) në individualitet për t'u bërë një nga artistët më të shquar dhe më novatorë bashkëkohorë shqiptarë. Megjithatë, krijimtaria e saj ende nuk është eksploruar dhe ekzaminuar plotësisht dhe është relativisht e panjohur në botën e artit kombëtar dhe veçanërisht ndërkombëtar.

“Lumturi Blloshmi. Nga e para” është konceptuar si një projekt ekspozitë që synon të prezantojë dhe pozicionojë sërish veprën dhe jetën e Lumturi Blloshmit në kontekstin e historisë së artit kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky prezantim përbëhet nga një përzgjedhje e veprave të Blloshmit nga vitet 1960 deri në vitet 2010, duke përfshirë autoportrete dhe kompozime në pikturë dhe fotografi që flasin po aq për thelbin estetik dhe realitetin personal të Blloshmit, sa dhe për kontekstin specifik politik dhe social në të cilin u krijuan. Duke i qëndruar besnike dëshirës së pafiltruar për të shprehur ndërgjegjësimin për përvojën, Blloshmi i shtyu vazhdimisht kufijtë e stileve mediatike dhe formale duke eksperimentuar me materiale dhe kombinime mediatike për të arritur atë që ajo e quajti "një univers i veçantë i prekshëm". E vendosur zyrtarisht brenda kufijve të figuracionit, krijimtaria e saj - e informuar fort nga imagjinata dhe inovacioni - në thelbin e saj transmeton dhe rezonon një ndjenjë universaliteti dhe kohëzgjatjeje. Pavijoni është konceptuar në mënyrë të tillë që të pasqyrojë universin e prekshëm por njëkohësisht të pakapshëm të Blloshmit dhe hapjen e tij ndaj interpretimeve. Arkitektura e ekspozitës do të krijohet në bashkëpunim me arkitekten gjermane Johanna Meyer-Grohbrügge.

Nëpërmjet një mjedisi të ndërtuar virtualisht publiku do të ketë qasje në botën personale dhe mjedisit krijues të Blloshmit. Kjo pjesë që synon krijimin e një lloj arkivi virtual do të krijohet në bashkëpunim të ngushtë mes kuratores dhe artistit britanik të realitetit virtual Alexander Walmsley. Do të krijohet një film për Lumturi Blloshmin në formën e një dokumentari eseistik. Ky i fundit synon të dokumentojë jetën e Blloshmit, punën e saj dhe qënien e saj. Dokumentari do të jetë në vetvete një lloj vepre artistike e bashkë-krijuar nga mendimet/veprat/imazhet e Lumturi Blloshmit dhe nga regjizori meksikan Tin Dirdamal në bashkëpunim me kuratoren.

Blloshmi, fatkeqësisht u nda nga jeta në nëntor 2020 për shkak të një infeksioni si pasojë e Covid-19. Megjithatë, ne jemi shumë të lumtur që puna e saj mund të ekspozohet dhe të ndahet më tej me publikun.

Skudra e Pavijonit Shqiptar:

Kuratore: Adela Demetja

Asistent kuratore: Eni Derhemi

Artist i Realitetit Virtual: Alexander Walmsley

Regjizor: Tin Dirdamal

Arkitekthe e ekspozitës: Johanna Meyer-Grohbrügge

Këshilltare e Pavijonit: Vivien Trommer

Përfaqësues ligjor i Lumturi Blloshmit: Ervin Blloshmi

Mbështetës: Ministria e Kulturës së Shqipërisë, Gwärtler Foundation

Media Partner: Digitalb

www.albanianpavilion2022.com

Lumturi Blloshmi, Artiste

E lindur në vitin 1944 në Tiranë, Shqipëri, Blloshmi ishte një nga artistet pamore shqiptare më të rëndësishme të kohës së saj. Babai i Blloshmit, oficer i ushtrisë së Mbretit Zog, u ekzekutua nga komunistët kur Lumturi ishte vetëm dy muajshe. Në moshën pesë vjeçare ajo humbi dëgjimin si pasojë e një infeksioni me meningjit. Blloshmi u diplomua në Degën e Pikturës në Akademinë e Arteve në Tiranë në vitin 1968. Nga viti 1974 deri në 1985, asaj nuk ju lejua të vazhdonte praktikën e saj artistike. Deri në vitin 2004, Blloshmi punoi në disa institucione, duke përfshirë këtu Galerinë Kombëtare të Arteve dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës në Tiranë. Pas kësaj, ajo punoi si artiste e pavarur. Disa nga veprat e saj janë përfshirë në koleksionin e Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Punimet e saj janë shfaqur ndër të tjera në ekspozita grupore dhe vetjake në institucione si Muzeu i Artit Chelsea në Nju Jork, Galeria Komonale e Arteve Bydgoszcz Poloni, Bienalen e Aleksandrisë për Vendet e Mesdheut

Egjipt, Galeria Kombëtare e Arteve e Shqipërisë, Galeria Kombëtare e Arteve e Kosovës. Lumturi ndërroi jetë më 27 nëntor 2020 si pasojë e një infeksioni me Covid-19.

Adela Demetja, Kuratore

Adela Demetja, kuratore e Pavijonit Shqiptar në Bienalen e 59-të të Venecias, e lindur në Tiranë, jeton dhe punon midis Frankfurtit dhe Tiranës. Ajo ka një diplomë master në "Studime Kuratoriale dhe Kritike" nga Städelschule dhe Universiteti Goethe, Frankfurt, Gjermani. Ajo është drejtoreshë e Tirana Art Lab – Qendrër për Artin Bashkëkohor, një institucion i pavarur arti të cilin e themeloi në vitin 2010. Si kuratore e pavarur ajo ka organizuar dhe kuruar ekspozita të shumta ndërkombëtare në Evropë dhe SHBA.

Eni Derhemi , Assistente Kuratore

Eni Derhemi dhe Adela Demetja njihen që prej 2016 dhe që prej këtij viti kanë punuar së bashku në raste të ndryshme. Eni Derhemi e lindur në vitin 1992 në Tiranë, është një artiste dhe kuratore shqiptare. Ajo ka një diplomë Bachelor në Dizajn dhe Arte nga Universiteti i Bozen-Bolzano dhe një Diplomë Master në Arte Pamore nga Universiteti i Bolonjës. Që nga viti 2010 ajo ka jetuar dhe punuar në skenën kreative midis Shqipërisë, Italisë dhe Gjermanisë. Në vitin 2020 bashkëthemeloi Ecumene Project, ku ka rolin e drejtueses së projektit dhe kuratores.

Tin Dirdamal, Regjisor

Regjisori Tin Dirdamal në bashkëpunim me kuratoren do të krijojnë një film në formën e një dokumentari eksperimental që trajton historinë e jetës së Blloshmit, qëndrimin dhe shpirtin e saj. Tin Dirdamal i lindur më 1982 në Meksikë është një regjisor autodidakt dhe artist ndërdisiplinor me studime formale në inxhinieri. Ai drejtoi dhe prodhoi No One (2005), Death in Arizona (2014) dhe Rivers of Men (2011). Ai ka marrë grante nga Instituti Sundance, Tribeca Film Institute dhe Rockefeller Media Artists. Filmat e tij janë shfaqur dhe vlerësuar në Sundance, Visions du Réel, IDFA, La Mostra de São Paulo, BAFICI, FICUNAM, ARTE (TV). Ai ftohet rregullisht për të dhënë leksione dhe seminare në vende dhe universitete të ndryshme duke përfshirë UCLA, Yale, NYU, Hunter, Union Docs (Brooklyn) dhe DocLab (Hanoi). Aktualisht jeton në Shqipëri.

Johanna Meyer-Grohbrügge, Arkitekte e ekspozitës:

Johanna Meyer-Grohbrügge është arkitekte, projektuese dhe profesore gjermane që ndërmerr projekte në mbarë botën. E trajnuar në arkitekturë në ETH Zürich, UNISI Mendrisio dhe IUAV Venezia, Johanna është një partner themelues i firmave të

arkitekturës June 14 Meyer-Grohbrügge & Chermayeff dhe Büro MEYER-GROHBBRUEGGE. Me qendër në Berlin, studio punon në një gamë të gjerë projektesh të drejtuara nga dizajni, duke filluar nga projekte më të mëdha si një ndërtesë banimi me 21 njësi që po zhvillohet në Berlin, deri te projekte të ndryshme në botën e artit për koleksione, galeri, panairë arti dhe ekspozita, si dizajni i koleksionit Julia Stochek dhe dizajni i ekspozitës së Bienales së 11-të të Berlinit. Johanna filloi karrierën e saj në SANAA / Kazuyo Sejima + Ryue Nishizawa ku punoi për më shumë se pesë vjet. Ajo ka dhënë mësim në Columbia GSAAP, në Universitetin Verilindor të Bostonit, në Universitetin e Uashingtonit St.

Alexander Walmsley, Artist i mediave interaktive

Artisti i mediave interaktive Alexander Walmsley në bashkëpunim me kuratoren Adela Demetja do të krijojë arkivin virtual interaktiv “Lumturi Biloshmi: Një Gjeografi Personale”, duke hedhur dritë mbi botën magjepsëse personale dhe krijues të Biloshmit. Alexander Walmsley i lindur në vitin 1992, është një artist dhe zhvillues me përvojë në antropologji dhe arkeologji. Ai punon me një sërë mediash dhe mjetesh, duke përfshirë fotografimin, fotogrametrinë, 3D, VR, hartografinë dhe regjistrimet në terren. Ekspozitat e fundit dhe ato të ardhshme përfshijnë Tirana Art Lab, Sharjah Art Foundation, The Photographers' Gallery, VRHam!, Kara Agora Art and Research Center dhe Kunstquartier Bethanien. Krahas praktikës së tij, ai aktualisht është gjithashtu një bashkëpunëtor kërkimor në Universitetin e Filmit Konrad Wolf në Potsdam, Gjermani.

Kontakt

Eni Derhemi, +393271241831

info@albanianpavilion2022.com

www.albanianpavilion2022.com